

PKR.nr.34/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarë profesionist, Suzana Çerkini kryetare, Arben Hoti dhe Beqir Kalludra anëtarë, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarit E. I. nga P., për shkak të veprës penale Vrasje nga neni 30 alinea 2 pika 2 dhe 3 e LPK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I nr.744/15 të datës 20.01.2016, pas shqyrtimit kryesor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 05.02.2016, 07.03.2016, 23.06.2016, 30.09.2016, 03.10.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari, të akuzuarit E. I., me mbrojtësin e angazhuar me autorizim, av.T.Rr. dhe të përfaqësuesit të palës së dëmtuar, Xh. A., me datë 05.10.2016, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari E. I.**, i biri i J., dhe nënës F., e vajzërisë P., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin P. Komuna P., me vendbanim në rr.”...”, p.n në P., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 25.09.2015.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse**, me datë 28.04.1993, rreth orës 19:30 deri në ora 20:00, në Podujevë, në rrugën ”Skenderbeu”, me dashje që ta privojë nga jeta personin tjetër, nga hakmarrja e paskrupullt e privon nga jeta të ndjerin Xh. A., duke e vu në rrezik jetën e personave tjerë të pranishëm, të dëmtuarve S. V., B. V., Xh. A., Xh. A., Gj. A., Q. Z. si dhe një fëmijë dy vjeçar të familjes A., në atë mënyrë që me datën e lartcekur, rreth orës 14:00-15:00, i dëmtuari Xh. A., vëllau i të ndjerit Xh. A. kishte qenë duke shkuar në shtëpinë e tij me biçikletë, në rrugën e lartcekur, ku më parë kishte qenë në qendër të qytetit për t’i prerë flokët, me të arritur te rrethi që lidhet me rrugën e fshatit Kërpimeh, pranë tij me veturën e tipit “Opel”, me ngjyrë të bardhë, kalon i pandehuri E. I., i cili e ka drejtuar veturën me shpejtësi të madhe dhe gjatë kalimit me pjesën e pasme të veturës, e godet në këmbën e majtë në rrotën e pasme të biçikletës të dëmtuarin Xh. A., dhe e rrëzon jashtë

rrugës përtokë, i njëjti posa ngritët reagon duke e fyer me fjalë fyese të pandehurin, por nuk e ka njohur të pandehurin, i pandehuri nuk reagon dhe vazhdon rrugën në drejtim të fabrikës së tullave, në të njëjtën rrugë për në shtëpinë e tij vazhdon edhe i dëmtuari dhe pasi kalon rreth 700 metra, në të njëjtën rrugë kthehet me veturën e lartcekur i pandehuri dhe ndalet në anën e djathtë të drejtimit të tij, në atë moment e ndal biçikletën edhe i dëmtuari, i pandehuri del nga vetura dhe shkon te i dëmtuari dhe papritmas e godet me grusht në kokë në anën e majtë mbi vetull, dhe më pas vazhdon kacafytja në mes tyre dhe gjatë kacafytjes i dëmtuari e merr një gurë aty afër, në madhësi të grushtit të dorës dhe e godet në gjoks të pandehurin, i njëjti ik dhe futet në veturë dhe gjatë ikjes i dëmtuari e gjuan me gurë në veturë, dhe rreth orës 19:30-20:00, derisa i dëmtuari S.V., kishte qenë për të vizituar vajzën e tij B., bashkëshortja e të ndjerit Xh. dhe, kishte dal për të shkuar në shtëpinë e tij me veturën e tipit “Opel Kadet”, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, të cilën më parë e kishte të parkuar në rrugë, para derës së oborrit të shtëpisë së Xh. A., babai i të ndjerit Xh. A., i pandehuri ka shkuar dhe është afruar me një distancë rreth 30 metra dhe me armën e paidentifikuar deri më tani ka shtënë së paku katër herë në drejtim të personave të lartcekur dhe njëra nga predhat e godet në bark të ndjerin Xh. A., kurse një predhë tjetër e godet veturën e të dëmtuarit S. V. në pjesën e pasme, në anën e djathtë, te dritat e pasme, për ti ofruar ndihmë mjekësore për shpëtimin e jetës së të ndjerit të dëmtuarit, Xh. dhe Xh. A. së bashku me S. V., me një veturë e dërgojnë në QKUK në Prishtinë, ku me rastin e pranimit mjekët kanë konstatuar se i ndjeri ka vdekur,

- me këtë ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 30 alinea 2 pika 2 dhe 3 të LPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 5,8,33, 38,41,50 të LPJ dhe neneve 326, 359, 360,365, 366 të KPP, i shqipton,

### **DËNIM ME BURGIM**

Në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh** në të cilin dënim do t’i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 25.09.2015 e tutje,

- **VAZHDOHET** Masa e Paraburgimit ndaj të akuzuarit E. I. deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se sa koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim,

- Obligohet i akuzuari t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, obligohet të paguajë shumën prej **100 (njëqind) euro**, në afat prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.744/2015, të datës 20.01.2016, ka akuzuar E. I. nga P., për veprën penale në vazhdimësi Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 dhe 1.8 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 05.02.2016, në të cilën i akuzuari, në prani të mbrojtësit të angazhuar me autorizim, av. Xh. R., mohoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë. Edhe në shqyrtim të dytë të mbajtur me datë 07.03.2016, me praninë e mbrojtësit tjetër të angazhuar av.T. Rr., gjithashtu mohoi fajsinë, mbrojtësi i propozoi gjykatës që i mbrojturi i tij t'i nënshtrohet një ekspertimi psikologjik për gjendjen e tij mendore në kohën e kryerjes së veprës penale. Pas aprovimit të propozimit nga gjykata dhe pas prezantimit të raportit psikiatrik nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, të datës 12.08.2016, është konstatuar se nuk ka të dhëna se i akuzuari ka qenë i penguar nga elemente psiçike të cilat do të dëmtonin aftësinë mendore që të kuptojë rëndësinë e veprës si dhe aftësinë e kontrollit të veprimeve të tij, gjykata ka caktuar senacën e rradhës të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 30.09.2016, në të cilën i akuzuari E.I., pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, vullnetarisht pranoi në tërësi fajsinë për veprën e kryer penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av.T. Rr., pranimin e fajsisë nga i mbrojturi i tij e mbështeti në tërësi, meqë paraprakisht është konsultuar mjaftueshëm, të njëjtin e ka vënë në dijeni për përparësitë ligjore me rastin e pranimit të fajsisë, andaj pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme, mirëpo kërkon vëmendjen e gjykatës që në rastin konkret të zbatojë ligjin më të favorshëm për të akuzuarin.

Prokurori i shtetit shprehu pajtimin për pranimin e fajsisë nga i akuzuari, meqë pranimi i fajësisë është konform dispozitave të KPP dhe i njëjti pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka të drejtë që në çdo fazë të procedurës të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë në të gjitha pikat e aktakuzës e cila është e mbështetur në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe, në bazë të të cilës u vërtetua se i akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 dhe 1.8 të KPRK, andaj i propozoi trupit gjykues që ta aprovoi pranimin e fajësisë.

Përfaqësuesi i familjes së dëmtuar, Xh. A., gjithashtu shprehu pajtimin për pranimin e fajsisë nga i akuzuari.

Në vazhdim, prokurori i shtetit i prezantoi gjykatës fjalën përfundimtare me shkrim, të njëjtën e lexoi duke shtuar në fund se prokuroria nuk ka arritur të sigurojë shënime nga evidenca kriminale e të akuzuarit nga baza e shënimeve në Kosovë, gjithashtu as nga shtetet e Europës ku ka lëvizur i akuzuari, por në seancën e shqyrtimit kryesor, derisa prokurori ka përmendur faktin se i akuzuari E. I. ka qenë në vuajtje të dënimit për një vrasje të kryer në Spanjë, vetë mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se ky fakt është i vërtetë, por kur i akuzuari ka arritur në aeroport në Prishtinë,

vullnetarisht ka lajmëruar policinë, dhe vullnetarisht është dorëzuar në polici, duke treguar për vrasjen këtu në Kosovë dhe atë në Spanjë. Në fjalën e shkruar përfundimtare, prokurori i shtetit theksoi se i akuzuari E. I., me dashje direkte dhe me paramendim ka kryer veprën penale, duke shti disa herë me armë deri më tani të paidentifikuar në drejtim të tani të dëmtuarve dhe të pranishmëve të tjerë, me ç'rast ka qëlluar për vdekje personin e pafajshëm në moshën 26 vjeçare, tani të ndjerin Xh. A.. Andaj, kërkon nga gjykata që të akuzuarin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit me çka do të lehtësohet dhimbja e familjes së të ndjerit, do të forcohet besim i qytetarëve se, njeriu dhe jeta e njeriut mbrohet me ligj dhe se drejtësia edhe nëse vonon nuk harron.

Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i tani të ndjerit Xh. A., Xh. A., e mbështeti fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, theksoi se nga gjykata pret vendim të drejtë, ndërsa kërkesë pasurore-juridike nuk do të parashtrijë fare, gjithashtu edhe vëllezërit tjerë Xh. A. dhe Xh. A. shprehimisht theksuan se nuk dëshirojnë kurfarë kompensimi.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. T. Rr., gjithashtu prezantoi fjalën përfundimtare në formë shkruar dhe të njëjtën e elaboroi shkurtimisht, fillimisht sqaroi se sa i përket konstatimit dhe pohimit të prokurorit se, kinse pas vrasjes që është objekt i akuzës, i akuzuari E. I. ka kryer edhe një vrasje në Spanjë, ky deklaram i prokurorit nuk mbështetet në dëshmi konkrete nga evidenca e të dënuarve, por mbështetet krejtësisht në atë që i mbrojturi i tij i kishte thënë policisë me rastin e arritjes në Aeroportin e Prishtinës, si dhe vet mbrojtësit, sidoqoftë thekson se trupit gjykues nuk duhet t'a merr si fakt të vërtetuar me rastin e marrjes së vendimit mbi lartësinë e dënimit. Meqenëse në seancën e shqyrtimit fillestar edhe vetë prokurori i shtetit është deklaruar para trupit gjykues dhe para auditoriumit, se ka dilema lidhur me parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm dhe prokurori këtë fakt e pranoi edhe në seancën e sotme, prandaj nëse prokurori ka pasur dilema, atëherë këto dilema në pajtim me nenin 3 par. 2 të KPP-parimi in dubio pro reo, është dashur t'i interpretoj në favor të të akuzuarit. Tani thekson se kjo çështje i mbetet trupit gjykues që të merr vendim të drejtë lidhur me pretendimet e mbrojtjes në raport me kualifikimin ligjor të veprës, meqë në rast të çdo mëdyshjeje, duhet vepruar në favor të akuzuarit. Në fjalën përfundimtare të shkruar, mbrojtësi ka theksuar se vepra është kryer në vitin 1993, në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji Penal i Kosovës (LPK) dhe Ligji Penal i Jugosllavisë (LPJ). Për veprën penale të Vrasjes së rëndë nga neni 30 alinea.2 të LPK, për kryesin e veprës ka qenë e paraparë dënimi me burgim prej jo më pak se dhjetë vjet ose dënimi me vdekje, ndërsa me LPJ është përcaktuar minimumi dhe maksimumi i dënimit me burgim prej 15 ditë deri 15 vjet. Me Rregulloren e Unmik-ut 1999/24, mbi ligjin e aplikueshëm në Kosovë, dënimi me vdekje është heqë, e meqë LPJ nuk ka paraparë dënim me burgim afatgjatë e as burgim të përjetshëm, ka mbetur vetëm dënimi me burgim, i paraparë në nenin 38 par.1 të LPJ, e që në rastin konkret në pajtim me nenin 3 të KPRK, duhet të merret si ligj më i favorshëm për të akuzuarin në kohën e kryerjes së veprës penale. Mbrojtësi në vazhdim i referohet rasteve nga praktika gjyqësore, si Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 1175/12<sup>1</sup>, në të cilin rast shpallja fajtor e kryesit dhe dënimi është bazuar në dispozitat e LPJ si ligj i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale. Në të njëjtin aktgjykim konstatohet “..... në mungesë të legjislacionit të

<sup>1</sup> Rasti kundër të akuzuarit F. G.

qartë, Gjykata e Apelit është e mendimit se në situatën kur dënimi me vdekje është shfuqizuar nga ana e Unmik-ut, më nuk mund t'i referohemi fjalisë së dytë të nenit 38 të LPJ dhe se dënimi maksimal me burgim mund të përcaktohet vetëm duke u bazuar në fjalinë e parë të nenit 38 të LPJ, si dhe në nenin përkatës të pjesës së posaçme që përcakton veprën penale për të cilën është dënuar i pandehuri". Pastaj mbrojtësi i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP-KZ.189/2004<sup>2</sup>, të datës 21.07.2005, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.592/11 të datës 7.12.2012<sup>3</sup> të vërtetuar nga Gjykata e Apelit në pjesën e vlerësimit të ligjit më të favorshëm për qëllimin e dënimit, Aktgjykimi PAKR 102/13 i datës 22.12.2013, gjithashtu qëndrim të njëjtë ka marrë Gjykata e Apelit edhe në rastin PAKR nr.55/14 të datës 25.10.2014<sup>4</sup>, duke dhënë konstatimin se "...Gjykata Themelore duke vendosur se ligji i zbatueshëm për dënim parasheh burgim prej 5 deri në 40 vjet, ka kryer lajthim juridik që patjetër duhet të korrigjohet". Në rastet e përmendura, dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë janë zvogëluar dukshëm. Në fund, thekson se dëshiron të shtojë se edhe Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, i cili ka monitoruar rastin B. I, ka konstatuar se gjykata gabimisht e ka aplikuar KPK, me rastin e shqiptimit si ligj më i favorshëm, sepse është dashur të aplikojë LPK. Rrrjedhimisht, i propozon gjykatës që nisur nga neni 3 i KPRK për zbatimin e ligjit më të favorshëm dhe, bazuar edhe në praktikën gjyqësore tashmë të aplikuar në disa raste, para marrjes së vendimit për sanksionin penal, të bëjë rikualifikimin e veprës penale, sa i përket mundësisë së dënimit maksimal që mund t'i shqiptohet të mbrojturit të tij. Në vazhdim numron rrethanat lehtësuese që duhet marrë parasysh nga gjykata, me rastin e matjes së dënimit, si pranimin e fajsisë, moshën e re të kryesit, shprehjen publikisht të keqardhjes dhe ngushllimit për familjen e të dëmtuarit, kalimin e kohës prej 23 vjetësh, meqë sipas praktikës gjyqësore, vetvetiu është arritur qëllimi i dënimit.

I akuzuari E. I. në fjalën përfundimtare e mbështet në tërësi mbrojtësin e tij dhe shpreh ngushëllime familjarëve të pranishëm të të ndjerit, kërkon falje për veprën e kryer, thekson se i vjen shumë keq për humbjen e jetës së tani të ndjerit me të cilin siç thotë kanë qenë shokë klase në vitin 1984-1985, i ndjeri ka qenë djalë bujar, andaj ndihet shumë i penduar për atë që ka ndodhur.

Pas deklaratimit të të akuzuarit se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet dhe, pajtimin për pranimin e fajsisë së të akuzuarit nga prokurori i shtetit, gjykata gjithashtu e aprovoi fajësinë nga i akuzuari, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza.

Gjykata, pas aprovimit të fajsisë së të akuzuarit dhe pas konstatimit të gjendjes së fakteve që e përmbanë akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarit, ekzistojnë elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj meqë më parë gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, të njëjtin edhe e shpalli fajtor.

<sup>2</sup> Rasti kundër të akuzuarit L. G.

<sup>3</sup> Rasti kundër të akuzuarit S. A.

<sup>4</sup> Rasti kundër të akuzuarit S.G.

Gjykata nuk ka gjetur kontestuese bazueshmërinë e veprës penale, por gjatë marrjes së vendimit sipas detyrës zyrtare është perkujdesur për zbatim të drejtë të dispozitave ligjore, përkatësisht për zbatim të ligjit më të favorshëm për të akuzuarin. Gjykata pati parasysh se në të gjitha ligjet materiale të zbatueshme në Kosovë, filluar nga ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale në fjalë, e deri më sot në Kodin Penal, ekziston dispozita e ligjit më të favorshëm, si parim i përgjithshëm të cilin zbatuesit e ligjit duhet aplikuar në çdo rast, përkatësisht ligjërisht ka qenë dhe mbetet e obliguar që ndaj kryesit të veprës penale të veprohet sipas ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së asaj vepre, e nëse ligji ka ndryshuar, atëherë duhet të veprohet sipas ligjit që është më i butë, apo më i favorshëm për të akuzuarin. Kështu është e precizuar në nenin 4 al. 1 dhe 2 të LPJ (1977), në nenin 2 par.1 dhe 2 të KPK (2004) dhe në nenin 3 par.1 dhe 2 të KPRK (2013).

Andaj, në këtë kontest, gjykata vlerësoi se ndaj të akuzuarit duhet bërë ricilësimin e veprës penale dhe atë, nga vepra penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 dhe 1.8 të KPRK (2013), në veprën penale vrasje e rëndë nga neni 30 alinea 2 pika 2 dhe 3 të LPK, për faktin se LPK ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale të vrasjes në fjalë dhe, ky ligj është më i butë, më i favorshëm për të akuzuarin, gjithnjë duke pasur parasysh se me Rregulloren e Unmik-ut 1999/24 është heqë dënimi me vdekje. Lidhur me ricilësimin ligjor të veprës, gjykata është udhëzuar gjithashtu edhe nga neni 360 të KPP tani në fuqi, meqë gjykata ka përcaktuar identitetin subjektiv të kryesit të veprës me gjitha pikat e dispozitivit të aktakuzës, pa asnjë ndryshim, andaj nuk është detyruar në propozimin e prokurorit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës. Gjykata ka akceptuar edhe faktin se nuk duhet aplikuar fjalinë e dytë të nenit 38 të LPJ, ku parashihet që në raste të jashtëzakonshme në rast të veprave penale të dënueshme me dënim vdekje, dënimi maksimal me burgim të jetë 20 vjet, për arsye se në situatën kur dënimi me vdekje është shfuqizuar, fjalia e dytë e nenit 38 të LPJ nuk mund të aplikohet, meqë do të konsiderohej interpretim i gabuar i ligjit material në dëm të të akuzuarit dhe vënje e gjykatës në lajthim juridik.

Me rastin e përcakimit të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit E. I., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimin, si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajsisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, shprehjen publike të pendimit dhe keqardhjes për veprën e kryer, ndërsa rrethanë rënduese gjeti faktin se i akuzuari është larguar nga vendi i ngjarjes, përkatësisht me qëllim të shmangies nga përgjegjësia ka dalë jashtë territorit të Kosovës, deri në ditën kur është arrestuar në Kosovë, kur edhe ka pranuar se ka kryer edhe një vrasje në Spanjë, dhe kjo ngjashmëri e veprave të kryera paraqet fakt rrethanor të cilin gjykata e merr si prirje të të akuzuarit për kryerje të veprës së natyrës së njëjtë, si vepër me rrezikshmëri të lartë shoqrore dhe, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor në lartësinë e precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje dënimi i tillë saktësisht i përgjigjet peshës së veprës penale, shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, me këtë edhe respektimin e të drejtës së çdo qytetari për të jetuar, si e drejtë absolute e garantuar në Kosovë dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimin, i paraparë me nenin 33 të LPJ (tani neni 41 të KPRK) dhe në fund, me bindje se i akuzuari në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngajshme.

Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 50 par.1 të LPJ.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale përfshirë shpenzimet për ekspertizë nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës të datës 15.08.2016, si dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.34/16, me datë 05.10.2016**

**Sekretarja juridike  
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja,  
Suzana Çerkini**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë